IDRIJA, SHTËPIA IME E RE!

Informacione në një vend për banorët e rinj të Komunës së Idrijës!

SQ

Mirë se vini në Idrija.

Mirë se vini në Idrija. Për shtëpinë tuaj keni zgjedhur një komunë që është krenare për trashëgiminë e saj të pasur dhe interesante minerare dhe kulturore, e cila gjithashtu krenohet me pasuritë e jashtëzakonshme natyrore. Miniera e merkurit në Idrija, gjatë historisë, ka tërhequr në trevat tona njerëz nga pjesë të ndryshme të Evropës, të cilët kanë vepruar këtu. Gjatë më shumë se 500 viteve të veprimtarisë minerare, banorët e Idrijës dhe të rrethinës, me njohuritë, këmbënguljen dhe zgjuarsinë e tyre, kanë krijuar një mjedis ku është bukur të jetosh.

Banorët e këtushëm jemi punëtorë, këmbëngulës, disi kokëfortë, por mbi të gjitha dimë ta mbështesim njëri-tjetrin. Bashkësia jonë ka një traditë të pasur dhe një ndjenjë të fortë përkatësie, ndërsa jemi shumë të lidhur me njëri-tjetrin. I mirëpresim me kënaqësi të gjithë ata që dëshirojnë të ndërtojnë një jetë të re në mesin tonë, por njëkohësisht presim gatishmëri për t'u integruar në mjedisin lokal, respektim të zakoneve të këtushme dhe pjesëmarrje në jetën e shoqërisë sonë. Shpresoj që kjo fletushkë t'ju ndihmojë që ta krijoni sa më lehtë shtëpinë tuaj në mesin tonë dhe të përfshiheni në mënyrë aktive në bashkësinë tonë.

Paçi fat!

Kryetari i Komunës së Idrijës
Tomaž Vencelj

Komuna e Idrijës

Komuna e Idrijës shtrihet në rajonin e Primorskës dhe ka rreth 12.000 banorë. Qendra e komunës është qyteti i Idrijës, me rreth 6.000 banorë. Territori i komunës është i ndarë në 10 bashkësi lokale: Qyteti Idrija, Spodnja Idrija, Çrni vrh, Godoviç, Vojsko, Kanomlja, Krnice-Masore, Ledine, Dole, Zavratec.

Territori i Komunës së Idrijës përfshin një sipërfaqe prej 294 km². Komuna ndodhet 58 km larg Lubjanës, 62 km larg Nova Goricës, 35 km larg Ajdovshçinës dhe 45 km larg Tolminit. Deri të gjitha qytetet e përmendura janë në dispozicion linja të rregullta të autobusëve.

Selia e komunës ndodhet në adresën Mestni trg 1. Në të njëjtën ndërtesë ndodhet edhe Njësia Administrative Idrija, në të cilën hyrja bëhet nga një hyrje tjetër, në adresën Shtudentovska 2. Shërbimi i Policisë Bashkiake të Idrijës i ka ambientet e veta në adresën Mestni trg 11, ndërsa Hapësira e Përbashkët e Qytetit Pr' Golitu ndodhet në adresën Mestni trg 15. Në faqen e internetit, sipas sektorëve, janë të shënuara edhe të dhënat e kontaktit të punonjësve të Komunës së Idrijës.

Të dhënat e kontaktit:

Komuna e Idrijës
Mestni trg 1, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.idrija.si
Tel.: +386 (0)5 373 45 00
E-posta: obcina.idrija@idrija.si

Orari zyrtar i punës me palë:

- E hënë, e martë dhe e enjte: nga ora 07.00 deri në 15.00
- E mërkurë: nga ora 07.00 deri në 17.00
- E premte: nga ora 07.00 deri në 13.00

Çfarë mund të rregulloj në Njësinë Administrative Idrija?

Në Njësinë Administrative mund të rregulloni të gjitha çështjet që lidhen me lejet e qëndrimit, regjistrimin e vendbanimit të përkohshëm/të përhershëm, lejen e njësuar për punë dhe qëndrim, lidhjen e martesës, lëshimin e certifikatës së lindjes, si dhe shumë çështje të tjera (patentë shoferi, dokumente të humbura etj.).

Më shumë informacione rreth shërbimeve administrative për të huajt mund të gjeni në faqen e internetit:

https://infotujci.si/

Nëse dëshironi t'i shmangni radhët e pritjes, mund të rezervoni një termin në Njësinë Administrative përmes aplikacionit elektronik "e-samonaročanje". Të gjitha informacionet i keni në portalin elektronik:

www.gov.si

Shumë çështje administrative mund t'i rregulloni edhe përmes portalit të administratës elektronike "e-uprava", në adresën:

https://e-uprava.gov.si/en

Të dhënat e kontaktit:

Njësia Administrative Idrija
Shtudentovska ulica 2, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.gov.si/drzavni-organi/upravne-enote/idrija
Tel.: +386 (0)5 373 43 00
F: +386 (0)5 377 33 32
E-posta: ue.idrija@gov.si

Orari zyrtar i punës me palë:

- E hënë, e martë dhe e enjte: nga ora 07.00 deri në 15.00
- E mërkurë: nga ora 07.00 deri në 17.00
- E premte: nga ora 07.00 deri në 13.00

Qendra për Punë Sociale: Njësia Idrija

Qendra për Punë Sociale e Primorskës Veriore, Njësia Idrija, mbulon territorin e Komunave Idrija dhe Cerkno. Në këtë qendër, përdoruesve u ofrohen informacione, këshillim dhe ndihmë për zgjidhjen e vështirësive sociale, familjare, financiare dhe personale. Trajtimi zhvillohet në mënyrë individuale, me besueshmëri dhe me nderim, duke u përpjekur t'u ofrohet mbështetje përdoruesve në gjetjen e zgjidhjeve dhe përmirësimin e gjendjes së tyre jetësore.

Qendra për Punë Sociale Idrija ndihmon në realizimin e të drejtave të ndryshme dhe përfitimin e ndihmave nga fondet publike, siç janë ndihma sociale në të holla, shtesa për fëmijë, subvencionimi i kopshtit të fëmijëve, bursa shtetërore, subvencionimi i mëngjesit dhe i drekës, si dhe forma të tjera të mbështetjes. Përdoruesve u ofrohet ndihmë për t'i kuptuar procedurat, për t'i plotësuar kërkesat dhe për t'i marrë informacionet e nevojshme. Shumë njerëz ndihen të pasigurt gjatë plotësimit të formularëve dhe zhvillimit të procedurave, prandaj përpiqen që gjithçka t'ua shpjegojnë sa më qartë dhe në mënyrë sa më të kuptueshme.

Prindërve u ofrohen informacione dhe ndihmë për realizimin e të drejtave që lidhen me lindjen e fëmijës dhe kujdesin për familjen, siç janë pushimi i lehonisë, pushimi i atësisë dhe pushimi prindëror, si dhe kompensimet prindërore. Gjithashtu, ofrojnë ndihmë për realizimin e të drejtave me rastin e lindjes së fëmijës dhe për çështje të tjera që lidhen me prindërimin.

Një pjesë e madhe e punës së tyre i kushtohet mbështetjes së fëmijëve, të rinjve dhe familjeve. Ata ndihmojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve familjare, vështirësive të fëmijëve dhe të rinjve, problemeve në shkollë, çështjeve të edukimit, si dhe në rastet e dhunës apo situatave të tjera të vështira jetësore. Ne gjithmonë kërkojmë zgjidhje që janë më të mirat për fëmijën dhe familjen. Për këtë qëllim, bashkëpunojmë edhe me shkollat, kopshtet e fëmijëve, institucionet shëndetësore dhe organizatat e tjera.
Një pjesë e rëndësishme e punës së tyre është edhe ofrimi

i ndihmës për personat e moshuar dhe familjarët e tyre. Ata ofrojnë këshillim lidhur me mundësitë e ndihmës në shtëpi, përkujdesjes institucionale, kujdesit afatgjatë, si dhe formave të tjera të mbështetjes që mund t'ua lehtësojnë individëve jetën e përditshme.

Qendra për Punë Sociale ushtron edhe kompetenca të rëndësishme publike. Kjo do të thotë se në procedura të caktuara vendos për të drejtat dhe interesat e individëve dhe familjeve. Ndër të tjera, merr pjesë në procedurat për rregullimin e kujdestarisë, përkujdesjes në familje strehuese, birësimit, mbrojtjes së fëmijëve, si dhe mbrojtjes së personave që, për arsye të ndryshme, kanë nevojë për ndihmë për t'u kujdesur për veten ose për të drejtat e tyre. Gjithashtu, bashkëpunon me gjykatat dhe institucionet e tjera dhe përgatit mendime dhe propozime profesionale.

Qendra për Punë Sociale Idrija zbaton programe të ndryshme për fëmijët, të rinjtë dhe përdoruesit e tjerë. Në shkolla organizohen punëtori dhe aktivitete, ku të rinjtë zhvillojnë aftësitë sociale, vetëbesimin dhe ndjenjën e përkatësisë. Për personat me probleme të shëndetit mendor organizohen grupe për mbështetje, shoqërim dhe ndihmë të ndërsjellë.

Ata janë në dispozicion për kontakt personal, përmes telefonit ose postës elektronike, gjatë orarit zyrtar të punës me palë.

Të dhënat e kontaktit:

Qendra për Punë Sociale e Primorskës Veriore
Njësia Idrija
Vojkova ulica 4a, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.csd-slovenije.si/csd-severna-primorska/enota-idrija/
Tel.: +386 (0)5 373 46 00
E-posta: gpcsd.idrija@gov.si

Orari zyrtar i punës me palë:

- E hënë: nga ora 08.00 deri në 12.00 dhe nga ora 13.00 deri në 15.00
- E mërkurë: nga ora 08.00 deri në 12.00 dhe nga ora 13.00 deri në 17.00
- E premte: nga ora 08.00 deri në 12.00

Si të siguroni sigurimin e detyrueshëm shëndetësor?

Sigurimin e detyrueshëm shëndetësor e zbaton Enti i Sigurimeve Shëndetësore i Sllovenisë (ESSHS), sipas parimeve të drejtësisë sociale dhe solidaritetit ndërmjet personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, të moshuarve dhe të rinjve, të pasurve dhe të varfërve. Sigurimi shëndetësor në Republikën e Sllovenisë (RS) është i detyrueshëm për të gjitha personat që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Ligjin për Kujdesin Shëndetësor dhe Sigurimin Shëndetësor (LKSHSSH). Sipas LKSHSSH, persona të siguruar janë të siguruarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në cilësinë e të siguruarve, duhet të përfshihen personat që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 15 të LKSHSSH, ndërsa në cilësinë e anëtarëve të familjes përfshihen personat që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 20 deri në 22 të LKSHSSH.

Për të siguruarit, sipas ligjit të lartpërmendur, është përcaktuar detyrimi për pagimin e kontributeve, me ç'rast është përcaktuar gjithashtu se kush është i detyruar për pagimin e tyre dhe kush është i detyruar për regjistrimin e personit në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, lloji i kontributeve dhe baza mbi të cilën paguhen ato, si dhe fushëveprimi i të drejtave.

Pagesa e kontributeve të përcaktuara është e lidhur me burimin që i siguron të siguruarit sigurinë themelore sociale (punësimi, pensioni, veprimtaria e pavarur, përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, mjetet vetjake, ndihmat sociale).

Në rast se një shtetas sllloven me vendbanim të përhershëm në Republikën e Sllovenisë nuk i plotëson kushtet për të qenë i siguruar sipas ndonjërës prej pikave 1 deri në 20 dhe pikave 22 deri në 25 të nenit 15 të LKSHSSH, atë e regjistron në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor Qendra kompetente për Punë Sociale, e cila gjithashtu konstaton plotësimin e kritereve që duhet t'i përmbushë personi. Anëtarët e familjes përfshihen në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor përmes të siguruarve si bartës të sigurimit, nëse nuk i plotësojnë kushtet për të qenë vetë të siguruar.

Regjistrimin, ndryshimin ose çregjistrimin e personave në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, përkatësisht nga ky sigurim, e kryen njësia rajonale ose dega e Entit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë (ESSHS), në bazë të kërkesës së subjektit të detyruar për regjistrim.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor u mundëson personave të siguruar realizimin e të drejtave për shërbime shëndetësore, barna, pajisje mjekësore, si dhe për kompensime në të holla, siç janë kompensimi i pagës gjatë mungesës së përkohshme nga puna dhe rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit në lidhje me realizimin e të drejtave për shërbime shëndetësore.

Kontributi i detyrueshëm shëndetësor

Sigurimi shëndetësor plotësues është shfuqizuar më 31. 12. 2023 dhe në janar të vitit 2024 është vendosur kontributi i ri i detyrueshëm shëndetësor (KDSH), i cili, së bashku me kontributet e deritanishme për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, siguron financimin 100% të të drejtave nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.

Të gjitha informacionet lidhur me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe kontributin e detyrueshëm shëndetësor mund t'i gjeni në faqen e tyre të internetit.

Të dhënat e kontaktit:

Njësia Rajonale Ljubljana, Dega Idrija
Kosovelova ulica 8, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.zzzs.si
Tel.: +386 (0)1 307 73 00
E-posta: OELJ@zzzs.si

Orari zyrtar i punës me palë:

- E hënë dhe e martë: nga ora 08.00 deri në 12.00 dhe nga ora 13.00 deri në 15.00
- E mërkurë: nga ora 08.00 deri në 12.00 dhe nga ora 13.00 deri në 17.00
- E premte: nga ora 08.00 deri në 13.00
- Të enjteve nuk ka orar zyrtar të punës me palë.

Çfarë shërbimesh ofron Qendra Shëndetësore Idrija?

Në Qendrën Shëndetësore Idrija dhe në Stacionin Shëndetësor Cerkno, i cili funksionon në kuadër të Qendrës Shëndetësore Idrija, veprojnë ambulancat e mjekësisë familjare, ambulancat stomatologjike, dispanseri për fëmijë dhe nxënës, si dhe shërbime të tjera shëndetësore, ku përveç kujdesit shëndetësor mund të merrni edhe këshillime të ndryshme.

Pasi ta keni rregulluar sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në Qendrën Shëndetësore Idrija zgjidhni mjekun tuaj personal, të cilin e vizitoni në rast të problemeve shëndetësore. Lista e mjekëve që ende pranojnë pacientë të rinj është e disponueshme në faqen e internetit të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë, në rubrikën „Zgjedhja e mjekut personal“, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Shëndetësore (ZD) Idrija, në rubrikën „Ambulancat e Qendrës Shëndetësore Idrija“. Mund të zgjidhni mjekun personal, pediatrin, gjinekologun ose stomatologun, nëse ai është i disponueshëm dhe ende pranon pacientë të rinj.

Të gjitha shërbimet mjekësore të Qendrës Shëndetësore Idrija mund t'i gjeni në lidhjen: ***https://www.zd-idrija.si/medicinske-sluzbe/***.

Për vizita në ambulanca mund të caktoni termin personalisht, përmes postës, me telefon (gjatë orarit të punës së ambulancës, përveç orës së fundit të këtij orari) ose përmes formularit për caktimin e terminëve (***eNaročanje zVEM Plus***).

Në dispozicionin tuaj është edhe pika e informimit, e cila funksionon çdo ditë pune nga ora 6.30 deri në 20.00. Ajo ndodhet në hollin pranë hyrjes kryesore të Qendrës Shëndetësore Idrija, ku mund të merrni të gjitha informacionet e nevojshme themelore. **Në Qendrën Shëndetësore Idrija sigurohet ndihma urgjente mjekësore 24 orë në ditë, gjatë gjithë ditëve të vitit.**

Në rastet urgjente, telefononi në numrin **112**.

Të dhënat e kontaktit:

Qendra Shëndetësore Idrija
Otona Zhupançiça 3, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.zd-idrija.si
Tel.: +386 (0)5 373 42 00
E-posta: zd.idrija@zd-idrija.si

Në kuadër të Qendrës Shëndetësore Idrija funksionojnë gjithashtu Qendra për Shëndetin Mendor të Fëmijëve dhe të Adoleshentëve, si dhe Qendra për Përmirësimin e Shëndetit. Në Qendrën për Përmirësimin e Shëndetit organizohen këshillime dhe punëtori falas në fushat e ushqyerjes së shëndetshme, aktivitetit fizik, ruajtjes së peshës së shëndetshme trupore, heqjes dorë nga zakonet e pashëndetshme (pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit etj.), kujdesit për shëndetin mendor, marrëdhënieve të mira ndërpersonale dhe menaxhimit të stresit. Programet u dedikohen të gjithë atyre që dëshirojnë të kujdesen në mënyrë aktive për shëndetin e tyre. Të drejtën për të marrë pjesë në këto programe e kanë personat me sigurim të rregulluar shëndetësor bazë, ndërsa të gjitha shpenzimet mbulohen nga Enti i Sigurimeve Shëndetësore i Sllovenisë (ESSHS).

Të dhënat e kontaktit:

Qendra për Përmirësimin e Shëndetit
Faqja e internetit: www.ckz.zd-idrija.si/
Tel.: +386 (0)5 373 42 22
E-posta: ckz@zd-idrija.si

Ku mund t'i marr barnat?

Me sigurimin e rregulluar të detyrueshëm shëndetësor, në Barnatoren Idrija mund të merrni falas barnat me recetë mjekësore, ndërsa barnat dhe preparatet e tjera janë në dispozicion kundrejt pagesës.

Të dhënat e kontaktit:

Barnatore Idrija
Arkova ul. 4, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.lekarnaljubljana.si/poslovalnice/lekarna-idrija
Tel.: +386 (0)1 230 61 00

Kopshti i fëmijëve

Në kopsht mund të përfshihen fëmijët nga mosha 11 muajsh të mbushur, përkatësisht nga momenti kur prindërit nuk e shfrytëzojnë më të drejtën e pushimit prindëror, deri në fillimin e shkollimit. Fëmijëve u ofrohet një mjedis i sigurt, nxitës dhe i këndshëm, në të cilin, përmes lojës, lëvizjes, hulumtimit, krijimtarisë dhe shoqërimit, fitojnë përvoja të rëndësishme dhe zhvillojnë fusha të ndryshme të zhvillimit të tyre. Kopshti i Fëmijëve Idrija zbaton programin ditor me kohëzgjatje deri në 9 orë. Programin edukativo-arsimor në grup e zbatojnë edukatori i fëmijëve parashkollorë dhe edukatori i fëmijëve parashkollorë – ndihmësi i edukatorit.

Në kopsht përpiqen që fëmijët të ndihen të pranuar, të sigurt dhe të dëgjuar. Për ta është e rëndësishme që çdo fëmijë të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë në grup, pavarësinë, vetëbesimin dhe marrëdhëniet pozitive me bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Vëmendje të veçantë i kushtojnë të mësuarit përmes lojës, lëvizjes, qëndrimit në natyrë dhe krijimit të një mjedisi të këndshëm shoqëror. Nxisin bashkëpunimin, ndihmën e ndërsjellë, respektimin e dallimeve dhe zhvillimin gradual të pavarësisë. Fëmijët kanë mundësi të përfshihen në aktivitete të ndryshme, projekte, ngjarje kulturore, shfaqje, festime, si dhe në bashkëpunim me mjedisin lokal. Në këtë mënyrë fitojnë përvoja të shumta, zhvillojnë kureshtjen, krijimtarinë dhe ndjenjën e përkatësisë ndaj bashkësisë.

Regjistrimi në kopshtin e fëmijëve

Regjistrimi i fëmijëve në kopsht zhvillohet gjatë gjithë vitit, ndërsa çdo vit, në muajin shkurt, kopshti shpall regjistrimin publik për vitin e ardhshëm shkollor. Prindërit e dorëzojnë kërkesën për regjistrim brenda afatit të përcaktuar, ndërsa kërkesat e pranuara pas këtij afati shqyrtohen në varësi të vendeve të lira në dispozicion. Informacionet për regjistrimin, dokumentacionin e nevojshëm dhe vendet e lira janë të disponueshme në faqen e internetit të kopshtit, përkatësisht te punonjësja e shërbimit këshillimor të kopshtit.

Për regjistrimin në kopsht është e nevojshme të plotësohet **formulari i regjistrimit**, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të kopshtit dhe të dërgohet me postë ose të dorëzohet personalisht në administratën e kopshtit (Arkova 7, 5280 Idrija). Formularin e regjistrimit mund ta dorëzoni edhe në çdo kohë gjatë vitit shkollor, ndërsa përfshirja në kopsht është e mundur në varësi të vendeve të lira.

Vërtetimi mjekësor

Për përfshirjen e fëmijës në kopsht është i nevojshëm edhe **vërtetimi mjekësor**, të cilin e plotëson mjeku personal i fëmijës (pediatri që ushtron veprimtarinë në Slloveni). Nga vërtetimi duhet të rezultojë se fëmija është vaksinuar kundër fruthit, shytave dhe rubeolës. Vërtetimi mjekësor duhet të dorëzohet **më së voni në ditën e përfshirjes së fëmijës në kopsht**.

Nëse fëmija ka **dietë** të veçantë, është e nevojshme që në kopsht të dorëzohet **vërtetimi për dietën e indikuar nga ana mjekësore**, të cilin e plotëson pediatri i fëmijës.

Pagesa e reduktuar e kopshtit të fëmijëve

Kopshti i fëmijëve nuk është falas për prindërit. Shuma e pagesës varet nga klasa e të ardhurave të familjes dhe përcaktohet nga Qendra kompetente për Punë Sociale, ku prindërit dorëzojnë kërkesën përkatëse në muajin para përfshirjes së fëmijës në kopsht.

- Kërkesa për realizimin e të drejtave nga fondet publike, përkatësisht për pagesën e reduktuar të kopshtit, duhet të dorëzohet në Qendrën për Punë Sociale për secilin fëmijë që përfshihet në kopsht.
- Kopshti është falas për fëmijën e dytë, nëse në kopsht është i përfshirë njëkohësisht edhe vëllai ose motra e tij më e madhe. Gjithashtu, kopshti është falas për fëmijën e tretë dhe për secilin fëmijë pasues, pavarësisht nëse vëllezërit ose motrat e tij janë të përfshirë në kopsht.

Përgatitjet për fillimin e kopshtit

- Mbledhja me prindërit e fëmijëve që regjistrohen për herë të parë në kopsht, në muajin qershor ose korrik.
- Bisedë individuale me dy punonjësit profesionalë të grupit (afërsisht një javë para përfshirjes së fëmijës në kopsht). Në këtë takim do të bisedoni për shprehitë e fëmijës (si e zë gjumi më lehtë, si qetësohet, me çfarë i pëlqen më shumë të luajë, si ushqehet ...), përvojat e deritanishme me përkujdesjen ndaj fëmijës, veçoritë eventuale shëndetësore dhe trajtimet e mundshme te specialistë të ndryshëm.

Përshtatja graduale e fëmijës në kopsht

Vëmendje të veçantë i kushtojnë përshtatjes graduale të fëmijës në kopsht, pasi dëshirojnë që kalimi nga mjedisi familjar të zhvillohet sa më qetë dhe në mënyrë sa më të këndshme. Prindërve u mundësojnë përfshirjen graduale të fëmijës në grup, si dhe bashkëpunimin me punonjësit profesionalë gjatë periudhës së përshtatjes. Bashkëpunimin e mirë ndërmjet familjes dhe kopshtit e konsiderojnë si një faktor të rëndësishëm për mirëqenien e fëmijës dhe përfshirjen e tij të suksesshme në kopsht.

Me fillimin e kopshtit është krejtësisht e zakonshme që fëmija të jetë më i ndjeshëm, të qajë më shpesh, të jetë më i lodhur ose të ketë përkohësisht vështirësi me gjumin dhe ushqyerjen. Këto janë reagime të zakonshme ndaj mjedisit të ri, njerëzve të rinj dhe ndryshimit të rutinës ditore. Te shumica e fëmijëve, këto vështirësi zvogëlohen gradualisht gjatë ditëve, përkatësisht javëve të para, kur ata mësohen me mjedisin e ri dhe ndihen më të sigurt në të.

Prandaj, prindërve u këshillojnë që për periudhën e përshtatjes të marrin **disa ditë pushimi** dhe të jenë të pranishëm në kopsht së bashku me fëmijën. Për orën e ardhjes dhe kohën që do ta kaloni në kopsht, merruni vesh me edukatoren. Gjatë ditëve të para, fëmija duhet të marrë me vete në kopsht lodrën e tij të preferuar, e cila do t'ia kujtojë shtëpinë.

Gjërat e nevojshme për fëmijën në kopsht

- Fëmijët duhet të kenë në kopsht **rroba dhe këpucë rezervë, pantofla me emrin e fëmijës, një qese për rrobat e ndotura dhe një sasi të mjaftueshme pelenash.**
- Në periudhën fillestare rekomandohet që fëmijët të kenë me vete edhe **biberonin qetësues dhe lodrën e preferuar** me të cilën janë të lidhur emocionalisht.

Bashkëpunimi me prindërit

Prindërit mund të marrin informacione për fëmijën dhe kopshtin përmes:

- **shkëmbimit të përditshëm të informacioneve** ndërmjet punonjësve profesionalë dhe prindërve,
- **orëve të konsultimit**, të cilat zhvillohen një herë në muaj (pritet që prindërit të marrin pjesë në to të paktën një herë në vit, përkatësisht në rast se punonjësit profesionalë i ftojnë në orët e konsultimit),
- **mbledhjeve me prindërit e grupeve**, të cilat zhvillohen tri herë në vit (është e dëshirueshme që prindërit të marrin pjesë në mbledhjet me prindërit),
- **takimeve të përbashkëta në nivel grupi dhe njësie,**
- **ligjëratave për prindërit.**

Informacionet e rëndësishme për prindërit publikohen në tabelat e njoftimeve pranë hyrjeve të dhomave të lojërave, në tabelat e njoftimeve të secilës njësi, ndërsa prindërit informohen për zhvillimet aktuale edhe përmes aplikacionit “Evio”.

Njoftimi për mungesën e fëmijës

Prindërit mund ta njoftojnë kopshtin për mungesën e fëmijës përmes telefonit ose **aplikacionit Evio**. Në rast të ndonjë sëmundjeje ngjitëse, rekomandohet që ta njoftojnë kopshtin edhe për këtë.

Rikthimi i fëmijës në kopsht pas sëmundjes

Në rastet e sëmundjeve dhe rikthimit të fëmijës në kopsht, respektohen rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (NIJZ) dhe të pediatrit të fëmijës. Gjatë rikthimit në kopsht pas kalimit të sëmundjes, rëndësi ka edhe mirëqenia e përgjithshme dhe gjendja shëndetësore e fëmijës, si dhe aftësia e tij për t'u ushqyer, për të fjetur dhe për t'u përfshirë në lojë në mënyrën e zakonshme.

Në rast të shfaqjes së sëmundjeve ngjitëse, si dhe lidhur me masat për parandalimin e tyre, kopshti i njofton prindërit përmes njoftimeve në tabelat e njoftimeve dhe aplikacionit Evio. **Në rast se fëmija sëmuret në kopsht, prindërit njoftohen menjëherë për këtë dhe prej tyre pritet që të vijnë ta marrin fëmijën e sëmurë sa më shpejt të jetë e mundur.** Në këtë mënyrë mbrohet shëndeti i fëmijëve të tjerë në kopsht, ndërsa fëmijës së sëmurë i mundësohet përkujdesja e duhur në shtëpi.

Trajtimi i hershëm

Në rast të vështirësive eventuale në fushën e zhvillimit të fëmijës, së bashku me fëmijën dhe prindërit kërkohen forma të përshtatshme të mbështetjes. Në këtë proces bashkëpunojnë kopshti, prindërit dhe specialistët e fushave të ndryshme në kuadër të ambulancës për zhvillimin e fëmijëve. Në rast se keni pyetje shtesë, mund t'i drejtoheni shërbimit këshillimor të kopshtit.

Kopshti i Fëmijëve Idrija ka disa njësi:

- **Njësitë Arkova dhe Prelovçeva në Idrija,**
- **Njësinë në Sp. Idrija dhe dy grupe në Ledine,**
- **Njësinë në Godoviç,**
- **Njësinë në Çrni Vrh.**

Të dhënat e kontaktit:

Kopshti i Fëmijëve Idrija
Arkova ul. 7, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.vrtec-idrija.si
Tel.: +386 (0)5 374 33 10 (sekretaria)
Tel.: +386 (0)5 374 33 11 (shërbimi këshillimor)
E-posta: vrtec.idrija@guest.arnes.si

Shkolla fillore

Arsimi fillor në Slloveni është i detyrueshëm, falas dhe zgjat nëntë vjet. Ai u dedikohet fëmijëve të moshës nga 6 deri në 15 vjeç, të cilët e përfundojnë procesin e shkollimit në shkollën fillore të njësuar nëntëvjeçare.

Në klasën e parë të shkollës fillore regjistrohet fëmija që gjatë vitit kalendarik, në të cilin do të fillojë ta ndjekë shkollën, mbush moshën 6 vjeç. Regjistrimi në shkollën fillore bëhet në muajin shkurt. Më shumë informacione rreth regjistrimit dhe programit, edhe për fëmijët tuaj që kanë qenë tashmë të përfshirë në arsimin fillor, do t'ju japin në shkollën fillore më të afërt me ju. Informacionet për pagesën e reduktuar të mëngjesit dhe drekës mund t'i merrni në Qendrën për Punë Sociale.

Programi i njësuar i shkollës fillore nëntëvjeçare ndahet në tri periudha trevjeçare (triada):


- Periudha e parë (klasa 1 deri në klasën 3): Mësimin kryesisht e zhvillojnë dy mësues, mësuesi kujdestar i klasës dhe mësuesi tjetër. Theksi vihet në zhvillimin e aftësive themelore të fëmijës për të mësuar më tej. Pra, në zhvillimin e gjithanshëm, njohuritë themelore dhe ndërlidhjen e njohurive.
- Periudha e dytë (klasa 4 deri në klasën 6): Kalimi gradual në mësim sipas lëndëve. Përveç mësuesit të klasës, lëndë të caktuara fillojnë t'i japin edhe mësuesit specialistë të lëndëve përkatëse. Theksi vihet në thellimin e njohurive, të kuptuarit, ndërlidhjen e njohurive dhe pavarësinë gjithnjë e më të madhe të nxënësit.
- Periudha e tretë (klasa 7 deri në klasën 9): Mësimi zhvillohet tërësisht sipas lëndëve. Nxënësit zgjedhin lëndët zgjedhore sipas interesave të tyre dhe përgatiten për arsimimin e mëtejshëm. Theksi zhvendoset edhe më shumë nga përvetësimi i njohurive themelore drejt të menduarit të pavarur, zbatimit të njohurive, të menduarit kritik dhe përgatitjes për arsimimin e mëtejshëm.

Vlerësimi Kombëtar i Njohurive (VKNJ)

Në Sllloveni, sipas rregullimit në fuqi, Vlerësimi Kombëtar i Njohurive (VKNJ) zhvillohet në klasat 3, 6 dhe 9, pra në përfundim të secilës periudhë edukativo-arsimore. VKNJ është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit. Qëllimi i tij themelor është të sigurojë informacione shtesë për arritjen e objektivave dhe standardeve të njohurive dhe, mbi këtë bazë, të planifikohet puna e mëtejshme. VKNJ koordinohet nga Qendra Shtetërore e Provimeve. Në klasën e 3-të vlerësohen njohuritë nga gjuha sllovene dhe matematika, në klasën e 6-të vlerësohen njohuritë nga gjuha sllovene, matematika dhe gjuha angleze, ndërsa në klasën e 9-të vlerësohen njohuritë nga gjuha sllovene, matematika dhe lënda e tretë, të cilën e përcakton çdo vit, më 1. 9., ministria kompetente. Rezultatet e arritura në klasën e 9-të mund të shërbejnë si kriter gjatë regjistrimit në shkollat e mesme me numër të kufizuar vendesh për regjistrim.

Programi shkollor ndahet në dy pjesë kryesore:

- **Programi i detyrueshëm**, i cili përfshin lëndët e detyrueshme (gjuhën sllovene, matematikën, gjuhën angleze, historinë, gjeografinë, shkencat natyrore, edukimin fizik etj.), ditët e aktiviteteve (ditët sportive, kulturore, të shkencave natyrore dhe teknike), si dhe lëndët zgjedhore.
- **Programi i zgjeruar**, i cili përfshin lëndët zgjedhore jo të detyrueshme, kujdesin e mëngjesit (për nxënësit më të vegjël), qëndrimin e zgjatur në shkollë, mësimin plotësues dhe shtesë, si dhe aktivitetet sipas interesave.



Në Komunën e Idrijës funksionojnë tri shkolla fillore qendrore:

- Shkolla Fillore Idrija, me shkollën vartëse në Godoviç dhe shkollën vartëse për arsimimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta, në të cilën zbatohet programi me standard më të ulët arsimor dhe programi i veçantë.
- Shkolla Fillore Spodnja Idrija, me shkollën vartëse në Ledine.
- Shkolla Fillore Çrni Vrh.

Të dhënat e kontaktit:

Shkolla Fillore Idrija
Lapajnetova 50,
5280 Idrija
Faqja e internetit: www.os-idrija.splet.arnes.si
Tel.: +386 (0)5 37 26 200
E-posta: osidrija@os-idrija.si

Shkolla Fillore Spodnja Idrija
Sholska ulica 9,
5281 Spodnja Idrija
Faqja e internetit: www.os-spidrija.si
Tel.: +386 (0) 5 37 74 700
E-posta: os-spidrija@guest.arnes.si

Shkolla Fillore Çrni Vrh
Çrni Vrh 95,
5274 Çrni Vrh nad Idrijo
Faqja e internetit: www.oscv.si
Tel.: +386 (0)5 37 43 654
E-posta: info@oscv.si

Shkolla e mesme

Gjimnazi Jurij Vega Idrija është një shkollë që zbaton tri programe të arsimit të mesëm: programin katërvjeçar të arsimit të përgjithshëm – gjimnaz, programin katërvjeçar të arsimit profesional – teknik i makinerisë dhe programin trevjeçar të arsimit të mesëm profesional – operator i mekatronikës. Programi i gjimnazit bën pjesë ndër programet më të vështira. Ai përfundon me maturën e përgjithshme, e cila është provim shtetëror.

Programi për teknik të makinerisë përfundon me maturën profesionale, e cila përfshin provimin me shkrim dhe me gojë nga gjuha sllovene, makineria, gjuha e huaj ose matematika, si dhe përgatitjen e një produkti, përkatësisht të një punimi seminarik, dhe mbrojtjen e tij. Për regjistrim është e dëshirueshme të keni njohuri të mira nga matematika dhe shkencat natyrore.

Shkollimi në programin operator i mekatronikës përfundon me provimin përfundimtar, i cili përfshin provimin me shkrim dhe me gojë nga gjuha sllovene dhe mbrojtjen me gojë të një produkti ose shërbimi.

Pas përfundimit të programit, shumica e nxënësve vazhdojnë shkollimin në programin dyvjeçar të arsimit profesional-teknik, përkatësisht mund të punësohen në industrinë metalike dhe elektroteknike, ku ekziston edhe mundësia e përfitimit të bursave.

Programi dallohet për përfshirjen e një vëllimi të madh të aftësimit praktik, të cilin nxënësit e zhvillojnë në punëtoritë e shkollës, në ndërmarrjet lokale dhe në ndërmarrjet jashtë vendit.

Regjistrimi në shkollën e mesme

Informacione për të huajt: ***https://infotujci.si/vkljucevanje-v-slovensko-druzbo/izobrazevanje/srednjesolsko-izobrazevanje/***

Regjistrimi në vitin e parë të shkollës së mesme zhvillohet, sipas parashikimeve, deri në fillim të muajit prill, në përputhje me kalendarin e afateve që përcakton Ministria e Edukimit dhe Arsimit. Nxënësit e ardhshëm mund të regjistrohen edhe gjatë vitit në programet që kanë ende vende të lira. Kusht për regjistrimin në shkollën e mesme është përfundimi me sukses i shkollës fillore.

Shkollimi i mëparshëm jashtë vendit

Nxënësit e ardhshëm të shkollës së mesme, të cilët janë shkolluar më parë jashtë vendit, duhet që gjatë regjistrimit të paraqesin kërkesë për njohjen e arsimit me qëllim të vazhdimit të shkollimit. Kërkesës duhet t'i bashkëngjisin:

- dokumentin e identifikimit dhe fotokopjen e tij,
- formularin N - ***https://e-uprava.gov.si/podrocja/vloge/vloga.html?id=2130&lang=si***,
- numrin amëz të qytetarit (EMŠO) të Republikës së Sllovenisë,
- dëftesën origjinale për përfundimin e shkollimit dhe fotokopjen e saj,
- të gjitha dëftesat duhet të jenë të përkthyera nga një përkthyes gjyqësor i betuar,
- kur bëhet fjalë për njohjen e arsimit të mesëm, duhet të bashkëngjiten dëftesat origjinale vjetore të shkollës së mesme dhe fotokopjet e tyre,
- përshkrimin e rrjedhës së shkollimit të përfunduar ose pjesërisht të përfunduar.

Nxënësve që kanë paraqitur kërkesë për njohjen e arsimit, shkolla u lëshon një vendim, me të cilin u njihet, përkatësisht nuk u njihet, e drejta për vazhdimin e shkollimit.

Kursi i gjuhës sllovene për nxënësit e shkollave të mesme, gjuha amtare e të cilëve nuk është sllovenishtja

Rregullorja për kursin e gjuhës sllovene për nxënësit e shkollave të mesme:: ***https://pisrs.si/pregledPredpisa?id=PRAV13433***

Nxënësi, gjuha amtare e të cilit nuk është sllovenishtja ose që nuk e ka përfunduar arsimin fillor në Republikën e Sllovenisë, gjatë përfshirjes së parë në arsimin e mesëm në Republikën e Sllovenisë, duhet të dëshmojë njohuritë e gjuhës sllovene me një vërtetim për kalimin me sukses të testit të njohurive të gjuhës në nivelin A2, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët. Nëse nuk e paraqet këtë vërtetim, nxënësi i nënshtrohet testit të njohurive të gjuhës në shkollë. Për nxënësit që nuk kanë paraqitur vërtetimin për kalimin me sukses të testit të njohurive të gjuhës në nivelin A2, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, përkatësisht që nuk e kanë kaluar testin, shkolla organizon një kurs intensiv të gjuhës sllovene në fillim të vitit shkollor.

Agjencia për Zhvillimin e Idrijës dhe Cerknos (ICRA)

Programe arsimore dhe aktivitete të tjera falas për të rriturit

Në Agjencinë për Zhvillimin e Idrijës dhe Cerknos (ICRA) organizohen programe të ndryshme arsimore, kurse dhe aktivitete të tjera për të rriturit, në të cilat mund të përfshihen edhe të huajt që jetojnë ose punojnë në zonën e Idrijës dhe Cerknos. Nëse nuk jeni të sigurt se cili program është i përshtatshëm për ju, mund t'i telefononi, t'u shkruani ose t'i vizitoni. Ata do t'ju ndihmojnë të gjeni programin e përshtatshëm dhe do t'ju shpjegojnë mënyrën e regjistrimit.

Mësimi i gjuhës sllovene

Integrimi Fillestar i Emigrantëve (IFE) është një program i njohur zyrtarisht, me kohëzgjatje prej 180 orësh, aktualisht falas, për mësimin e gjuhës sllovene dhe njohjen me shoqërinë, historinë dhe kulturën sllovene. Ai u dedikohet emigrantëve që nuk janë shtetas të Bashkimit Evropian (shtetasve të vendeve të treta) dhe që i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në program.

Pjesëmarrësit përvetësojnë njohuri të gjuhës sllovene për komunikimin e përditshëm dhe njihen me përmbajtje të rëndësishme për jetesën në Slloveni. Programi i përgatit ata edhe për provimin e njohurive të gjuhës sllovene.

Për t'u përfshirë në program, është e nevojshme që në Njësinë Administrative të pajiseni me Vërtetimin për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në programin e njësuar, me të cilin më pas i drejtoheni Agjencisë për Zhvillim të Idrijës dhe Cerknos (ICRA), ku do t'ju ndihmojmë të përfshiheni në program.

https://www.icra.si/projekt/60/zacetna-integracija-priseljencev-zip/

Programet arsimore për të rriturit në Rajonin e Goricës


Në kuadër të projektit Programet Arsimore për të Rriturit (IPO), në Rajonin e Goricës organizohen programe arsimore falas për të rriturit. Programi i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së të huajve.

Zbatohen programe arsimore të njohura zyrtarisht dhe programe arsimore joformale:

- Kurse të gjuhës sllovene,
- Kurse të gjuhëve të tjera të huaja,
- Kurse për përvetësimin e kompetencave digjitale,
- Programe të Aftësimit për Sukses në Jetë (ASJ),
- Programe të tjera të arsimit të përgjithshëm për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të rëndësishme për punën dhe jetën e përditshme, si për shembull edukimi financiar, kompetencat sociale dhe qytetare, sipërmarrja, zhvillimi i qëndrueshëm, mënyra e shëndetshme e jetesës dhe kompetenca të tjera themelore,
- Programe përgatitore për dhënien e provimit të njohurive të gjuhës sllovene.

Programet përfshijnë 40, 60 ose 100 orë mësimore. Oferta e programeve ndryshon gjatë vitit, prandaj rekomandohet që programet aktuale t'i kontrolloni në faqen e internetit të ICRA-s ose të kontaktoni drejtpërdrejt me ta.

https://www.icra.si/projekt/70/ipo-izobrazevalni-programi-za-odrasle-v-goriski-regiji/



Qendra Shumëbrezore e Rajonit të Goricës – QSH Gorishka

ICRA është partnere në projektin Qendra Shumëbrezore e Rajonit të Goricës – QSH Gorishka, e cila ofron aktivitete falas, mundësi shoqërimi, informim, mbështetje dhe këshillim për të lehtësuar përfshirjen në bashkësinë lokale.

QSH u dedikohet njerëzve të brezave të ndryshëm, ndërsa vëmendje të veçantë u kushton individëve dhe familjeve që kanë nevojë për mbështetje shtesë gjatë përfshirjes në shoqëri, ndër të cilët bëjnë pjesë edhe emigrantët dhe refugjatët, si dhe familjet e tyre.

Organizohen ligjërata, punëtori arsimore dhe praktike, takime bashkëbisedimi dhe aktivitete të tjera që mundësojnë shoqërimin, përvetësimin e njohurive të reja, si dhe ndërlidhjen ndërmjet brezave dhe kulturave të ndryshme.

Aktivitetet aktuale publikohen në faqen e internetit të ICRA-s dhe përmes kanaleve të tjera të informimit.

https://www.icra.si/projekt/73/vecgeneracijski-center-goriske/

Të dhënat e kontaktit:

Agjencia për Zhvillimin e Idrijës dhe Cerknos
Mestni trg 2, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.icra.si
T.: +386 (0)5 37 20 180
E.: info@icra.si

Gimnazija Jurija Vege Idrija

Arsimi i të rriturve

Më shumë informacione: ***https://www.gim-idrija.si/izobrazevanje-odraslih-2/***

Në kuadër të arsimit të të rriturve, kandidatëve u ofrohen:

- Vetëarsimimi, i cili është një formë e përshtatshme arsimimi për ata që dëshirojnë të përgatiten për provime në mënyrë të pavarur, pa ligjërata të organizuara, ose për kandidatët që dëshirojnë të japin ndonjë provim që u mungon për përfundimin e programeve për të cilat shkolla jonë është e akreditуar: operator i mekatronikës, formësues i metaleve – vegëltar, teknik i makinerisë në programin e arsimit të mesëm profesional (SSI) dhe në programin e arsimit profesional-teknik (PTI), si dhe gjimnazi. Për secilin kandidat përgatitet një plan individual për realizimin dhe përfundimin e programit. Gjatë këtij procesi, kandidatit i njihet arsimimi i arritur, provimet e dhëna më parë dhe përvoja e tij e punës.
- Nëse tashmë zotëroni aftësi dhe njohuri të caktuara për një profesion të caktuar, por nuk keni dëshmi formale për to, mund të përfshiheni në programin Kualifikimi Profesional Kombëtar (KPK) dhe në këtë mënyrë të arrini sa më shpejt të ushtroni profesionin e dëshiruar. Aktualisht zbatohen kualifikimet: ndihmës/e i/e mirëmbajtësit në prodhim dhe operator/e i/e makinerive në prodhim.
-

Mësimi i pavarur

Teksti mësimor Naslon

Teksti mësimor Naslon: tekst mësimor interaktiv për të rriturit, në gjuhën sllovene, angleze dhe shqipe: ***https://centerslo.si/knjige/ucbeniki-in-prirocniki/osnovna-stopnja/naslon/***

Teksti mësimor Naslon është i disponueshëm në të njëjtën lidhje edhe në versionin jointeraktiv, në formatin PDF, i cili mund të printohet.

Përmbajtja bazohet në nevojat reale të komunikimit të të rriturve që janë shpërngulur së fundmi në Slloveni, gjatë periudhave fillestare të jetesës së tyre në Slloveni.
Ai përfshin fjalorin, shprehjet e zakonshme dhe tekstet me të cilat ka shumë të ngjarë të ndesheni kur të keni nevojë për dokumente në Njësinë Administrative, ndihmën e mjekut, një banesë e të ngjashme. Përmban gjithashtu informacione për punën dhe profesionet, si dhe për sistemin publik arsimor.


Tekste të tjera mësimore (A1–A2):

https://centerslo.si/knjige/ucbeniki-in-prirocniki/osnovna-stopnja/

Kurset në internet

Slonline: aplikacion i cili, pasi të shkarkohet në telefon, funksionon edhe pa lidhje me internetin. Është i disponueshëm në tetë gjuhë: ***https://play.google.com/store/apps/details?id=si.digied.slonline&hl=en&pli=1***

Në kompjuter mund ta përdorni përmes kësaj lidhjeje: ***https://www.slonline.si/***



Punësimi i të huajve

Të huajt, shtetas të Bashkimit Evropian, Norvegjisë, Islandës, Lihtenshtajnit ose Zvicrës, kanë qasje të lirë në tregun e punës në Slloveni, që do të thotë se mund të punësohen pa leje pune.

Të huajt, shtetas të të ashtuquajturave vende të treta, duhet që para punësimit në Slloveni të pajisen me leje pune. Hapi i parë është të gjeni një punëdhënës në Slloveni. Listën e vendeve aktualisht të lira të punës mund ta kërkoni dhe ta printoni sipas kritereve të ndryshme (arsimimi, profesioni, zona ku kërkoni punësim) në faqen e internetit ***www.ess.gov.si***.

Pasi të gjeni një punëdhënës që është i gatshëm t'ju punësojë, mund të paraqisni kërkesë për lëshimin e lejes së njësuar të qëndrimit dhe të punës, e cila ju mundëson hyrjen, qëndrimin, punësimin dhe punën në Slloveni. Kërkesën për lejen e njësuar e paraqisni në Njësinë Administrative, nëse tashmë ndodheni në Slloveni, përkatësisht në përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Sllovenisë në shtetin tuaj. Para paraqitjes së kërkesës, njoftoni punëdhënësin, pasi ai duhet t'i ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore në ditën e paraqitjes së kërkesës.

Procedurën e lëshimit të lejes së njësuar të qëndrimit dhe të punës e zhvillon Njësia Administrative, ndërsa Enti i Punësimit jep pëlqimin për lejen e njësuar të qëndrimit dhe të punës, nëse janë plotësuar të gjitha kushtet (të cilat ndryshojnë në varësi të llojit të pëlqimit).

Përjashtim: **Për punësimin e shtetasve sipas marrëveshjeve me Bosnjën dhe Hercegovinën (BiH) dhe Serbinë, si dhe për punët sezonale** në bujqësi/pylltari dhe turizëm/hoteleri e gastronomi, që zgjasin më pak se 90 ditë, **procedura e lëshimit të lejes së punës zhvillohet pranë Entit të Punësimit. Leja e punës e lëshuar nga Enti i Punësimit** konsiderohet si pëlqim për lejen e njësuar të qëndrimit dhe të punës, të cilën e lëshon Njësia Administrative në Slloveni.

Vetëpunësimi i të huajve

Të huajt mund të vetëpunësohen pas një viti qëndrimi të pandërprerë dhe të ligjshëm në Slloveni ose pas regjistrimit në regjistrin e bizneseve. Në këtë rast nuk kërkohet pëlqimi i Entit të Punësimit. Nëse dëshironi të hapni një biznes individual (s.p.) ose një ndërmarrje tjetër, mund t'i drejtoheni pikës SPOT në Idrija (ICRA dhe OOZ Idrija), ku do t'ju ndihmojnë me procedurën e regjistrimit dhe procedurat e tjera. Më shumë informacione ***https://spot.gov.si/sl***

Informacionet e përgjithshme lidhur me punësimin e të huajve dhe formularët përkatës janë në dispozicion në faqen e internetit: ***https://www.ess.gov.si/iskalci-zaposlitve/zaposlitev-tujih-drzavljanov/***

Për informacione lidhur me kërkesat dhe procedurën e lëshimit të lejes së njësuar të qëndrimit dhe të punës, kontaktoni Njësinë Administrative që zhvillon procedurën.

Në Entin e Republikës së Sllovenisë për Punësim, në zyrën për punëdhënësit, ofrojmë informacione lidhur me kontrollin e tregut të punës, dhënien e pëlqimeve për punësimin e të huajve, punësimin e të huajve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të punësimit me Bosnjën dhe Hercegovinën (BiH) dhe Serbinë, si dhe punët sezonale që zgjasin më pak se 90 ditë.

Territori i Njësisë Administrative Idrija mbulohet nga zyra për punëdhënësit pranë Shërbimit Rajonal të Entit të Punësimit në Nova Gorica, ku mund të paraqiteni personalisht gjatë orarit zyrtar të punës me palë, në adresën Ul. Tolminskih puntarjev 4, Nova Gorica, ose të kontaktoni në numrin e telefonit 05 33 50 206 apo përmes postës elektronike: ***gpzrsznovagorica@ess.gov.si***

PIKA INFORMATIVE PËR TË HUAJT, e cila funksionon në kuadër të Entit të Punësimit me qëllim të **sigurimit të mbështetjes gjithëpërfshirëse për punëtorët migrantë dhe punëdhënësit e tyre**, mund ta kontaktoni në numrin e telefonit +386 (0)1 330 81 20 ose përmes postës elektronike info-tocka@ess.gov.si, pasi ajo ofron informacione, këshillim dhe ndihmë lidhur me punësimin dhe punën e të huajve. Për më shumë informacione, vizitoni faqen e internetit: ***https://www.ess.gov.si/iskalci-zaposlitve/zaposlitev-tujih-drzavljanov/infotocka-za-tujce***

Për t'u informuar se cilat janë **të drejtat dhe detyrimet e punëtorit migrant, përkatësisht të punëdhënësit**, mund t'i drejtoheni **Këshillimores për Punëtorët** (Delavska svetovalnica) në numrin pa pagesë 080 1434 ose përmes faqes së internetit ***www.delavskasvetovalnica.si***

Të dhënat e kontaktit:

Enti i Republikës së Sllovenisë për Punësim (ZRSZ), Zyra e Punës Idrija
Rozhna ulica 2a, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.ess.gov.si/iskalci-zaposlitve/
Tel.: +386 (0)5 377 10 69

Ndërmarrjet

Në Komunën e Idrijës veprojnë dy ndërmarrje të mëdha ndërkombëtare, Kolektor d.d. dhe Hidria d.o.o., të cilat së bashku punësojnë disa mijëra persona. Të dyja ndërmarrjet kanë përvojë shumëvjeçare në punësimin e shtetasve të huaj dhe u ofrojnë punonjësve të rinj mbështetje gjatë punësimit, ardhjes në Sllloveni dhe përfshirjes në mjedisin e punës.

Të dhënat e kontaktit:

Kolektor d.d.
Vojkova 10, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.kolektor.com/kariera
E-posta: zaposlitev@kolektor.com

Hidria d.o.o.
Spodnja Kanomlja 23,
5281 Spodnja Idrija
Faqja e internetit: www.hidria.com/careers
E-posta: people.growing.together@hidria.com



Si mund ta kaloj kohën e lirë?

Në Komunën e Idrijës veprojnë një numër i madh shoqatash sportive, kulturore dhe artistike. Për shpalljet publike dhe komunikimin me shoqatat kujdeset Departamenti për Veprimtari Shoqërore pranë Komunës së Idrijës, nën përgjegjësinë e të cilit funksionon edhe Hapësira e Përbashkët Qytetare Pr' Golitu (Mestna dnevna soba Pr' Golitu). Në këtë hapësirë organizohet çdo muaj një program i larmishëm dhe falas, i cili përfshin ligjërata, takime shoqërore, programe arsimore, punëtori dhe aktivitete të tjera, të dedikuara për të gjithë banorët e Komunës së Idrijës. Hapësira e Përbashkët Qytetare Pr' Golitu është kështu një pikënisje për përfshirjen në jetën shoqërore të Komunës së Idrijës ose për marrjen e informacioneve rreth aktiviteteve dhe ngjarjeve në qytet.

Të dhënat e kontaktit:

Hapësira e Përbashkët Qytetare Pr' Golitu
Mestni trg 15, 5280 Idrija
Tel.: +386 (0)51 263 050
E-posta: prgolitu@idrija.si

Qendra Rinore Idrija (Mladinski center Idrija) prej më shumë se dhjetë vjetësh kujdeset për nevojat, interesat dhe dëshirat e të rinjve, duke u ofruar atyre një mjedis të sigurt dhe nxitës për shoqërim, krijimtari, mësim dhe zhvillim personal. Përmes programeve, projekteve dhe ngjarjeve të ndryshme, qendra u mundëson të rinjve të fitojnë përvoja, të zhvillojnë ide dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në formësimin e jetës në bashkësinë lokale dhe më gjerë. Në kuadër të Qendrës Rinore Idrija funksionon edhe Hosteli Idrija, ndërsa në ambientet e ndërtesës ndodhet gjithashtu Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj Idrija.

Të dhënat e kontaktit:

Qendra Rinore Idrija
Ulica IX. korpusa 17, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.mcidrija.si
Tel.: +386 (0)51 231 049
E-posta: info@mcidrija.si

Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj Idrija ofron një hapësirë të sigurt për shoqërim, ndihmë gjatë mësimit, bashkëbisedim dhe kalimin cilësor të kohës së lirë.

Të dhënat e kontaktit:

Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj Idrija
Ulica IX. korpusa 17, 5280 Idrija
Tel.: +386 (0)31 635 070
E-posta: dc.idrija@gmail.com

Në Komunën e Idrijës funksionon Biblioteka dhe Salla e Leximit e Qytetit, me njësi në Idrija, Sp. Idrija dhe Çrni Vrh. Në kuadër të saj funksionojnë edhe Kinemaja Idrija, si dhe galeritë Magazin dhe Sv. Barbara. Regjistrimi në bibliotekë është falas, nëse plotësohen kushte të caktuara, ndërsa huazimi i librave pas regjistrimit është falas. Në dispozicion është një numër i madh librash në gjuhë të huaja, si dhe materiale për mësimin e gjuhës sllovene.

Të dhënat e kontaktit:

Biblioteka dhe Salla e Leximit e Qytetit Idrija
Ulica sv. Barbare 4-5, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.idr.sik.si
Tel.: +386 (0)5 373 40 60
E-posta: knjiznica.idrija@mkci.si

Kontaktet e përgjithshme

Policia

Në Idrija funksionon Stacioni i Policisë Idrija, i cili mbulon të gjithë territorin e Komunës së Idrijës.

Të dhënat e kontaktit:

Stacioni i Policisë Idrija
Gregorçiçeva ulica 5, 5280 Idrija
Tel.: +386 (0)5 37 24 800
E-posta: pp_idrija.pung@policija.si

Zjarrfikësit

Në Idrijë funksionon Shoqata e Zjarrfikësve Vullnetarë Idrija, e cila mbulon të gjithë territorin e komunës. Në Lidhjen e Zjarrfikësve Idrija bëjnë pjesë edhe nëntë shoqata të tjera vullnetare, që veprojnë në bashkësi të ndryshme lokale. Të gjitha shoqatat funksionojnë mbi baza vullnetare dhe mirëpresin gjithmonë anëtarë të rinj.

Të dhënat e kontaktit:

Shoqata e Zjarrfikësve Vullnetarë Idrija (PGD Idrija)
Vojkova ulica 2A, 5280 Idrija
Faqja e internetit: www.pgd-idrija.si
E-posta: info@pgd-idrija.si

Numri i Telefonit për Emergjenca

Numri i përbashkët i emergjencës në Bashkimin Evropian është 112. Duke telefonuar këtë numër, mund të kontaktoni shërbimet e emergjencës, përfshirë ambulancën, zjarrfikësit dhe policinë. Policinë mund ta kontaktoni gjithashtu në mënyrë anonime dhe pa pagesë në numrin 080 1200.

Këshilla për Thirrjet e Emergjencës

Kur telefononi në numrin 112, jepni informacionin e mëposhtëm:

- **Kush** po telefonon
- **Çfarë** ka ndodhur
- **Ku** ka ndodhur
- **Kur** ka ndodhur
- **Sa persona** janë lënduar
- **Çfarë lëndimesh** kanë pësuar
- **Cilat janë kushtet në vendngjarje** (zjarr, materiale të rrezikshme, tubacione gazi ose instalime të tjera të dëmtuara)
- **Çfarë ndihme** ju nevojitet

Knjižica z informacijami za priseljence je nastala v sklopu LAS projekta RAZGIBAJMO ZNANJE

Projekt prispeva k razvoju lokalne skupnosti z izboljšanjem večnamenske javne infrastrukture, višjo kakovostjo bivanja, socialno vključenostjo ranljivih skupin ter spodbujanjem enakopravnosti in aktivne participacije prebivalcev. Temelji na medgeneracijskem sodelovanju, odgovornem odnosu do okolja in ohranjanju kulturne dediščine ter s tem ustvarja dodano vrednost za lokalno skupnost in njen dolgoročni razvoj.

Celotna vrednost projekta: 463.776,72 €
Sofinanciranje: 199.900,01 €

